

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI: SHËRBIM MOBILE, PËR QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS
MJEKËSORE**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 64212000-5 Shërbimet telefonike mobile

Fondi limit: 1,662,964.16 (Një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër pik gjashtëmbëdhjetë) lekë, **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim të Përgjithshëm të Lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e paraqitjes së ofertës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me objektin dhe specifikimet teknike të prokurimit, të cilat përfshijnë ofrimin e shërbimit të komunikimit celular zanor, transmetimin e të dhënave, APN-në e dedikuar dhe aksesin në rrjetin 4G/5G. Autorizimi i Përgjithshëm nga AKEP garanton që operatori ekonomik është i autorizuar për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike objekt prokurimi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme justifikohet nga nevoja për të siguruar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet teknike dhe përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Kjo vlerë përbën një element sigurie që garanton zbatimin me sukses të kontratës, në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë dhe respektimin e plotë të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, të paktën 2 (dy) specialistë të diplomuar në fushat e Elektronikës, Informatikës, Teknologjisë së Informacionit ose fusha të ngjashme.

Për këta punonjës, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse;
- kontratë pune (e vlefshme);
- Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuadër, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë staf të kualifikuar dhe personel teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të shërbimit, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë teknikë është e lidhur drejtpërdrejt dhe në mënyrë proporcionale me objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike. Prania e stafit të kualifikuar në fushat e Elektronikës, Informatikës, Teknologjisë së Informacionit ose fusha të ngjashme është e nevojshme për konfigurimin dhe administrimin e shërbimit të komunikimit celular, transmetimit të të dhënave dhe APN-së së dedikuar, si dhe për monitorimin dhe mbështetjen teknike të shërbimit 24/7, sipas nivelit SLA të kërkuar. Numri minimal prej 2 specialistësh synon të garantojë vazhdimësinë dhe ndërhyrjen në kohë gjatë realizimit të shërbimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH ISO/IEC 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standardi ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme lidhet me nevojën për të garantuar menaxhimin e kontrolluar dhe cilësor të shërbimeve objekt prokurimi, përfshirë administrimin, monitorimin dhe mbështetjen teknike, në përputhje me kërkesat e përcaktuara për vazhdimësinë dhe nivelin SLA të shërbimit.

S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; lidhet me natyrën e shërbimit, i cili përfshin transmetimin e të dhënave dhe përdorimin e APN-së së dedikuar. Ky standard synon të garantojë zbatimin e masave të përshtatshme për menaxhimin e sigurisë së informacionit, mbrojtjen e të dhënave dhe kontrollin e aksesit gjatë ofrimit të shërbimit.

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, kjo deklaratë është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik konfirmon përmbushjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Paraqitja e kësaj deklarate shërben si garanci paraprake nga operatori ekonomik se shërbimi i ofruar do të realizohet në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe me natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur/hartuar/përcjellë nga Autoriteti Kontraktor “**Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore**”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.